



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 23, datë 13.02.2025.

PËR

**“KOMANDIMIN E NJË PROKURORI SI KËSHILTAR LIGJOR,
PRANË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/ Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar (në mungesë)
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar (në mungesë)
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 13.02.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159 - 161, 164 e vijues, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe nenet 18 e vijues të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për komandimin e 1 (një) Prokurori si Këshilltar Ligjor, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 149/a, pika 1, 149/a, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë;
2. Nenet 159, pika 1 dhe 2 të 164, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;



3. Nenet nenet 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar;
4. Nenet 32 dhe 52 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
5. Germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", e ndryshuar;
6. Pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm".

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, dëgjoi relatorin Z. Olger Eminaj, si edhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim Këshilli) me Vendimin nr. 224, datë 23.10.2024, ka miratuar fillimin e procedurave për plotësimin e një pozicioni Këshilltar Ligjor pranë institucionit, përmes procedurës së komandimit, për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
2. Njoftimi për shprehjen e interesit për pozicionin e shpallur u publikua në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, me afatin fundor të aplikimit për kandidatët e interesuar datën 12.11.2024, ora 24:00.
3. Në kuadër të detyrave që Këshilltari Ligjor do të kryejë, kriteret e kërkuara për këto pozicione u përcaktuan si më poshtë :
 - të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
 - të ketë ushtruar profesionin e magjistratit për të paktën 5 (pesë) vite;
 - të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - kandidati të mos jetë në kushtet e papajtueshmërisë ambjentale për shkak të lidhjeve të ngushta familjare me Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Sekretarin e Përgjithshëm ose prokurorët e tjerë të komanduar në Këshill, sipas parashikimeve të nenit 8, pika 1 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i ndryshuar.
 - Dokumentacioni i kërkuar ishte si më poshtë :
 - Letër motivimi, ku kandidati shpreh arsyet dhe motivin e kandidimit për këtë pozicion pune (jo më shumë se dy faqe A4);
 - CV- në e përditësuar të kandidatit;
 - Deklaratën e papajtueshmërisë ambjentale;
 - Çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm në funksion të këtij kandidimi.
4. Nga verifikimi, pas përfundimit të afatit aplikuan për këtë pozicion 3 (tre) prokurore, si më poshtë:
 - Aida Cakaj, prokurore pranë Zyrës së Prokurorisë Fier;
 - Alma Bramo, prokurore pranë Zyrës së Prokurorisë Durrës;
 - Pranvera Gruda, prokurore pranë Zyrës së Prokurorisë Durrës.

5. Nga verifikimi i kriterëve rezultoi se të gjithë kandidatët që kanë aplikuar brenda afatit, janë prokurore të Republikës së Shqipërisë, si dhe nuk kanë masa disiplinore në fuqi.

6. Në vijim të procedurës për plotësimin e një pozicioni për këshilltar ligjor, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë nëpërmjet procedurës së komandimit të prokurorëve, bazuar në nenin 54 pika 4, e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Këshilli ka proceduar me këto vendimmarrje:

7. Me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2025, ka miratuar Opinionin për kandidaten që ka aplikuar në procedurën e komandimit si Këshilltar Ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë për një periudhë prej 3 (tre) vitesh, znj. Aida Cakaj.

8. Me Vendimin nr. 2, datë 10.01.2025, ka miratuar Opinionin për kandidaten që ka aplikuar në procedurën e komandimit si Këshilltar Ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë për një periudhë prej 3 (tre) vitesh, znj. Alma Bramo.

9. Vendimin nr. 3, datë 10.01.2025, ka miratuar Opinionin për kandidaten që ka aplikuar në procedurën e komandimit si Këshilltar Ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë për një periudhë prej 3 (tre) vitesh, znj. Pranvera Gruda.

10. Bashkë me miratimin e Opinioneve për tre aplikuesit, Këshilli ka vendosur që dokumentet e paraqitura nga aplikantët t'i përcillen Komisionin e Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale (në vijim KVVEP) për vijimin e procedurave të mëtejshme.

11. Nisur nga sa më sipër, KVVEP në njohje të plotë të situatës aktuale të krijuar nga vakancat në sistem, vlerëson se funksioni i prokurorëve të komanduar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë është i rëndësishëm, pasi lidhet me procesin e vlerësimit periodik etiko-profesional të prokurorëve.

12. KVVEP u mbledh në datë 14.01.2025, ora 10.00, dhe pas administrimit të vendimeve të zbardhura të Këshillit për aplikantët, në prani të Kryetarit të Komisionit Z. Moisi Duda, Anëtares zëvendësuese Znj. Arta Mando (për shkak të dorëheqjes nga kjo procedurë të Anëtarit të Komisionit Z. Erind Merkuri, për shkak të ekzistencës së një konflikti interesi me një prej kandidatët), pjesëmarrjes online të anëtarit z. Olger Eminaj, dhe të këshilltarëve ligjorë të Komisionit, zhvilloi hedhjen e shortit për caktimin e relatorit i cili do të ndiqte zhvillimin e procedurës dhe përgatitjen e relacionit, si dhe projektvendimit që iu paraqit fillimisht Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike Profesionale dhe më pas, seancës plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për miratimin e renditjes përkatëse.

13. Gjithashtu, Komisioni në rrugë elektronike njoftoi aplikantët për Relatorin dhe vijimin e procedurës përzgjedhëse nga KVVEP.

14. Komisioni më datë 20.01.2025 vendosi t'ju kërkoj opinione dy drejtuesve të prokurorive ku aktualisht ushtrojnë detyrën aplikantët që konkuruan për pozicionin e këshilltarit, duke kërkuar, nëse "cënohet funksionaliteti i atyre prokurorive në rast përzgjedhje të një prej aplikantëve për të shërbyer si këshilltare pranë KLP-së".

15. Në rrugë elektronike ju dërgua kërkesa dy Drejtuesve dhe më datën 21.01.2025, Drejtuesja Suela Beluli më 22.01.2025 Drejtuesi Elion Mustafaj, konfirmuan po në rrugë elektronike, se: "përzgjedhja nga ana e KLP-së të një prej aplikanteve për këshilltar nuk e cenon funksionalitetin e punës në prokurorinë respektive".

16. Ndërkohë u vijua puna me përgatitjen e relacionit duke marrë në analizë të hollësishme të gjithë dokumentacionin e administruar, si atë të marrë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe

Trajnimeve në institucion dhe atë të dërguar nga aplikantët. Gjithashtu, u kërkua në internet për publikime të mundshme në emrat e aplikantëve me qëllim shterimin e kërkimeve dhe plotësimin sa më objektiv të vlerësimit të kandidaturave për Këshilltar Ligjor pranë KLP-së.

17. Përsa i përket mënyrës së vlerësimit të kandidatëve, rezultoi se me Vendimin nr.224, datë 23.10.2024, Këshilli, përcaktoi disa kritere hyrëse, të cituara më sipër, si dhe disa kritere vlerësuese, me qëllim vlerësimin sa më objektiv të këtyre kandidatëve.

18. Bazuar në këto kritere, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duke pranuar propozimin e KVVEP, vendosi që t'i vlerësojë, si më poshtë:

- **Në lidhje me kriterin e vjetërsisë në funksion. Ka vjetërsinë më të madhe në ushtrimin e funksionit të prokurorit.** Ky kriter vlerësohet maksimalisht me 30 (tridhjetë) pikë dhe fillon nga viti i gjashtë i përvojës profesionale, duke llogaritur nga 1 pikë për çdo vit përvojë.

Mbi bazën e kësaj metode, kandidatët, u vlerësuan për këtë kriter, si më poshtë:

- Aida Cakaj – 11 vite përvojë – 6 pikë;
- Alma Bramo – 9 vite përvojë – 4 pikë;
- Pranvera Gruda – 17 vite përvojë – 12 pikë.

- **Ka ekspertizë në fushën e hartimit të akteve rregullatore;** Ky kriter vlerësohet maksimalisht me 10 (dhjetë) pikë duke llogaritur 2(dy) pikë për çdo akt rregullator të hartuar prej tyre.

Mbi bazën e kësaj metode, duke qenë se asnjë nga kandidatët nuk solli materiale për projektakte rregullatore që të jenë hartuar prej tyre, u vlerësuan për këtë kriter, si më poshtë:

- Aida Cakaj – 0 akte – 0 pikë;
- Alma Bramo – 0 akte – 0 pikë;
- Pranvera Gruda – 0 akte – 0 pikë.

- **Është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës.** Ky kriter vlerësohet maksimalisht me 10 (dhjetë) pikë duke llogaritur 2(dy) pikë për çdo botim. Për më shumë se 5(pesë) botime, merren pikët maksimale në çdo rast

Mbi bazën e kësaj metode, kandidatët, u vlerësuan për këtë kriter si më poshtë:

- Aida Cakaj – 1 botim – 2 pikë;
- Alma Bramo – 0 botime – 0 pikë;
- Pranvera Gruda – 0 botime – 0 pikë.

- **Ka njohuri në një nga këto gjuhë: anglisht, gjermanisht, frengjisht, spanjisht, italisht.** Ky kriter vlerësohet maksimalisht me 10 pikë duke llogaritur: i) 10 pikë për dëshminë e gjuhës së huaj, niveli C2, ii) 8 pikë për dëshminë e gjuhës së huaj, niveli C1, iii) 6 pikë për dëshminë e gjuhës së huaj, niveli B2; iv) 4 pikë për dëshminë e gjuhës së huaj, niveli B1; v) 2 pikë për dëshminë e gjuhës së huaj, niveli A;

Mbi bazën e kësaj metode, kandidatët, u vlerësuan për këtë kriter, si më poshtë:

- Aida Cakaj – Anglisht “B2” – 6 pikë;
- Alma Bramo – Anglisht “B2” – 6 pikë;
- Pranvera Gruda – pa dhëshmi – 0 pikë.



Kandidatet kanë deklaruar se zotërojnë gjuhët:

- Aida Cakaj – Anglisht, Frengjisht dhe Italisht;
- Alma Bramo – Anglisht, Frengjisht dhe Italisht;
- Pranvera Gruda – Anglisht, Frengjisht dhe Italisht.

Pavarësisht këtyre deklarimeve, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerësoi që të marrë në konsideratë vetëm dëshmitë e sjella dhe të bëjë pikëzimin, sipas metodës së përshkruar më sipër.

- ***Ka aftësi shumë të mira profesionale, organizative, personale, si edhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.*** Për këtë kriter Këshilli i Lartë i Prokurorisë mori në konsideratë dhe vlerësoi faktin se të tre kandidatet kanë qenë Drejtuese për periudha të shkurtra kohore në seksione apo prokurori ku kanë ushtruar funksionin e drejtuesit dhe më konkretisht:

- Pranvera Gruda ka ushtruar funksionin e titullarit për 1 (një) vit në Prokurorinë e Apelit Shkodër;
- Alma Bramo ka ushtruar funksionin Zy/Drejtuese për 2 (dy) vjet në Prokurorinë Mat;
- Aida Cakaj për 1 (një) vit ka ushtruar funksionin si Drejtuese e Seksionit të Posaçëm, në Prokurorinë Fier.

Për këtë arsye, duke pranuar propozimin e Komisionit, Këshilli vendosi të vlerësojë me 29 (dy) pikë për çdo vit funksionin e drejtuesit të Prokurorisë dhe me nga (një)1 pikë për çdo vit funksionin e Zv/drejtuesit të Prokurorisë dhe drejtuesit të seksionit, por jo më shumë se 10 (dhjetë) pikë.

Mbi bazën e kësaj metode, kandidatët, u vlerësuan për këtë kriter, si më poshtë:

- Aida Cakaj – 1 (një) vit Drejtuese Seksioni – 1 pikë;
- Alma Bramo – 2 (dy) vite zy/Drejtuese Prokurorie – 1 pikë;
- Pranvera Gruda – 1 (një) vit Drejtuese Prokurorie – 3 pikë.

- ***Ka trajnime.*** Ky kriter nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë vlerësohet maksimalisht 10(dhjetë) pikë, ku një trajnim vlerësohet me 1 (një) pikë. Më shumë se 10 trajnime vlerësohet në çdo rast maksimalisht:

Mbi bazën e kësaj metode, kandidatët, u vlerësuan për këtë kriter, si më poshtë:

- Aida Cakaj – 34 trajnime – 10 pikë;
- Alma Bramo – 7 trajnime – 7 pikë;
- Pranvera Gruda – 17 trajnime – 10 pikë.

- ***Ka angazhime të tjera:*** Për të vlerësuar këtë kriter, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë janë marrë në konsideratë veprimtaritë e tjera të kryera dhe lidhja e tyre me sistemin e prokurorisë apo me procesin e vlerësimit të prokurorëve. Ky kriter vlerësohet maksimalisht 10 pikë, ku secili vit përvoje vlerësohet me 1 (një) pikë. Për më shumë se 10 (dhjetë) vite përvojë, merren pikët maksimale për çdo rast. Për këtë aspekt nga kandidatët rezultuan të dhënat e mëposhtme:

- Aida Cakaj, nuk ka ushtruar funksion tjetër veç atij të prokurorit;



- Alma Bramo, ka punuar oficere e policisë gjyqësore nga viti 2000 – 2015;
- Pranvera Gruda, ka ushtruar funksionin e Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit për Prokurorinë në Ministrinë e Drejtësisë nga viti 2001 deri në vitin 2011 dhe ndihmëse ligjore në Prokurorinë e Përgjithshme nga vitit 2011 deri në vitin 2019.

Mbi bazën e kësaj metode, kandidatët, u vlerësuan për këtë kriter, si më poshtë:

- Aida Cakaj – pa angazhime – 0 pikë;
- Alma Bramo – pa angazhime – 0 pikë;
- Pranvera Gruda – 18 vite – 10 pikë.

19. Bazuar në metodologjinë e mësipërme, rezulton se kandidatët vlerësohen me pikë si më poshtë:

	Vjetërsia	Ekspertiza	Botime	Gjuha e huaj	Aftësitë profesionale	Trajnime	Angazhime të tjera	Total
Aida Cakaj	6	0	2	6	1	10	0	25
Alma Bramo	4	0	0	6	1	7	0	18
Pranvera Gruda	12	0	0	0	3	10	10	35

20. Bazuar në këtë vlerësim, kandidatët, rezultojnë të renditur, si më poshtë:

- Pranvera Gruda 35 (tridhjetë e pesë) pikë;
- Aida Cakaj 25 pikë (njëzet e pesë) pikë;
- Alma Bramo 18 pikë (tetëmbëdhjetë) pikë.

21. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në parashikimet e neneve 53, dhe 54 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 164, pika 8, 166 pika 2, 176 pika 3, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit Nr. 115/2026 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe në analizën e mësipërme pasi verifikoi plotësimin e kriterëve specifike të kandidatëve sipas legjislacionit në fuqi, e vlerëson të përfunduar procesin e përzgjedhjes të kandidatit për t’u komanduar si Këshilltar Ligjor në KLP, duke përcaktuar znj. Pranvera Gruda dhe duke e komanduar si Këshilltare Ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për një afat 3 (tre)- vjeçar, për periudhën që fillon nga data 1 mars 2025 dhe përfundon me datë 29 shkurt 2028.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenet 149/a, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenit 53, dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 164, pika 8, 166 pika 2, 176 pika 3, 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit Nr. 15/2026 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Relacionit shpjegues i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI :

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve për t’u komanduar si Këshilltar Ligjor, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

- a. Pranvera Gruda 35 (tridhjetë e pesë) pikë

- b. Aida Cakaj 25 (njëzet e pesë) pikë
c. Alma Bramo 18 (tetëmbëdhjetë) pikë

2. Komandimin e zonjës Pranvera Gruda, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, në pozicionin e Këshilltarit Ligjor, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Afati i komandimit fillon në datën 01.03.2025 dhe përfundon në datën 29.02.2028.
4. Të njoftohen për këtë vendim zonja Pranvera Gruda, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 13.02.2025.



KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Olger Eminaj

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erion Fejzulla